



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 09.09.2019, ora 11.00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit 3-javor të komisionit
2. Miratimi i kalendarit të mbledhjeve jashtë institucionit.
3. Shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11225, datë 15.07.2019 “Për kthimin e ligjit nr. 36/2019 “Për një ndryshim në ligjin nr. 9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”

Të ftuar:

Bledar Dervishaj – këshilltar ligjor i Presidentit

Krisilda Fana – Drejtore Juridike dhe e Sigurisë në Presidencë.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Eljo Hysko, Luan Duzha, Myslim Murrizi, Antoneta Dhima, Xhemal Qefalia, Lefter Maliqi, Luan Harusha, Anduel Xhindi dhe Elena Xhina.

Mungojnë:

Alban Zeneli, Edmond Rrushi, Paulin Sterkaj, Ylli Shehu dhe Arben Elezi.

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita, kolegë!

Fillojmë mbledhjen e parë të Komisionit parlamentar të Sigurisë Kombëtare për këtë sesion.

Uroj që periudha e pushimeve të ketë qenë një periudhë e mirë për të gjithë ju dhe të ftuarit në këtë mbledhje të komisionit.

Sot në rendin e ditës kemi parashikuar miratimin e kalendarit 3-javor të komisionit, për të cilin besoj se jeni njohur në kalendarin e punës së Kuvendit që në seancën e parë të mbajtur për këtë sesion parlamentar.

Si pikë e dytë do të jetë miratimi i kalendarit të mbledhjeve që ne duhet të zhvillojmë si veprimtari jashtë parlamentare dhe si pikë e tretë do të jetë shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11225, i korrikut të vitit 2019 “Për kthimin e ligjit nr. 36 të vitit 2019 për një ndryshim në ligjin “Për rezervat materiale të shtetit” me të dhënat përkatëse të ligjit.

Përpara se të prezantoj të ftuarit për ditën e sotme, dua të ftoj kolegët të votojnë nëse janë dakord me kalendarin e Komisionit të Sigurisë Kombëtare dhe atë që parashikon lëvizjet jashtë Kuvendit.

Kush është dakord me kalendarin?

Miratohej dy pikat e para të rendit të ditës.

Kalojmë në shqyrtimin e dekretit të Presidentit të Republikës për ndryshimin e miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në ligjin “Për rezervat materiale të shtetit”.

Kujtoj kolegët se në qershor të këtij viti ne kemi miratuar një ndryshim për rezervat materiale të shtetit. Projektligji, i cili duke u votuar u kthye në ligj, u iniciua nga Ministria e Mbrojtjes. Ky projektligj, i votuar me 20 qershor të vitit 2019, i ka kaluar për dekretim Presidentit të Republikës, i cili, duke përfituar nga kompetenca kushtetuese, që ia lejon neni 85 i Kushtetutës, ka vendosur të kthejë për rishqyrtim ndryshimin e paraqitur në ligjin “Për rezervat materiale të shtetit”.

Për të diskutuar për dekretin dhe për qëndrimin që Komisioni i Sigurisë Kombëtare do të ketë ndaj dekretit, natyrisht këtë qëndrim do t’ia sugjeroja edhe Kuvendit të Shqipërisë, të ftuar nga institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë kemi zonjën Krisilda Fana, e cila është Drejtore Juridike dhe e Sigurisë. Relatore, për qëndrimin që Komisioni i Sigurisë do të ketë ndaj dekretit të Presidentit të Republikës, është sekretarja e Komisionit të Sigurisë, zonja Antoneta Dhima.

Si fillim fjalën do t'ia jap zonjës Fana, e cila do të na parashtrojë argumentet e paraqitura në dekretin e Presidentit të Republikës.

Fjala është për ju, zonja Fana.

Krisilda Fana – Faleminderit, zonja kryetare!

Si fillim, ju uroj sesion të mbarë!

Siç e kemi parashtruar edhe në shkresën e dekretit të Presidentit të Republikës dhe në arsyetimin e bashkëlidhur, Kuvendi i Shqipërisë në seancën plenare të datës 20 qershor të vitit 2019 ka miratuar ligjin nr. 36/2019 “Për një ndryshim në ligjin nr. 9900 të datës 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”, i përcjell për dekret dhe shpallje me shkresën nr. 25/96, datë 26 qershor 2019 të Kuvendit

Nga vlerësimi i praktikës parlamentare rezulton se ky projektligj është propozim i Këshillit të Ministrave, nismë e Ministrisë së Mbrojtjes. Kjo nismë ligjore është shqyrtuar nga Komisioni i Sigurisë Kombëtare në Kuvendin e Republikës në cilësinë e komisionit përgjegjës.

Referuar relacionit shpjegues të Këshillit të Ministrave, që ka shoqëruar propozimin e projektligjit, si dhe raportin e datës 17 qershor të vitit 2019 të Komisionit për Sigurinë Kombëtare, rezulton se ndryshimi ligjor i miratuar synon të thjeshtojë procesin e livrimit të mallrave rezervë të shtetit, që bëjnë pjesë në grupin “A”, duke zëvendësuar miratimin e livrimit të tyre me vendimin e Këshillit të Ministrave, siç parashikohet aktualisht në ligjin në fuqi me një akt individual, urdhër të Kryeministrit.

Sipas relacionit të Këshillit të Ministrave dhe raportit të Komisionit për Sigurinë Kombëtare, kjo mënyrë e re e vendimmarrjes bëhet për shkak se miratimi i mallrave të grupit “A” bëhet nëpërmjet një akti kolegjial të Këshillit të Ministrave dhe kjo gjë sjell vonesa nga momentin e daljes së aktit, deri në livrimin e mallrave.

Presidenti i Republikës për shqyrtimin e ligjit nr. 36/2019 iu referua përmbajtjes së vetë aktit të dërguar për dekretim dhe shpallje, si dhe praktikës parlamentare të ndjekur për këtë qëllim. Presidenti vlerësoi përputhshmërinë e këtij ligji, duke bërë një analizë të përmbajtjes së qëllimit, për të cilin ky akt është propozuar në raport me interesin publik.

Nga shqyrtimi i ligjit nr. 36/2019 rezulton se ndërmarrja e kësaj iniciative ligjore është e pajustificuar ligjërisht dhe për më tepër kjo mënyrë e re e livrimit të mallrave, pjesë e rezervave shtetërore, nëpërmjet urdhrit të Kryeministrit nuk garanton plotësisht mbrojtjen e interesit publik në procedurat e administrimit dhe livrimit të mallrave me vlerë që përbëjnë grupin kryesor të mallrave të shtetit.

Kuvendi i Shqipërisë nëpërmjet ligjit nr. 9900, datë 10.04.2008, “Për rezervat materiale të shtetit” ka krijuar bazën ligjore të nevojshme për rregullimin e të gjitha marrëdhënieve që

lindin, ekzistojnë dhe shuajnë gjatë administrimit, mirëmbajtjes dhe kontrollit të pronësisë së rezervave materiale të shtetit. Ky ligj i miratuar nga Kuvendi nuk është ndryshuar për një periudhë 11-vjeçare dhe implementimi i tij në praktikë nuk rezulton të ketë sjellë ndonjë problematikë apo të jetë bërë pengesë në veprimtarinë administrative të strukturave shtetërore të ngarkuara për zbatimin e tij.

Referuar përcaktimeve të neneve 2 dhe 3 të ligjit ekzistues “Për rezervat materiale të shtetit,” është e qartë se Kuvendi i Shqipërisë ka vlerësuar të përcaktojë me ligj rëndësinë madhore që ka krijimi, administrimi dhe përdorimi i rezervave materiale të shtetit, të cilat, përveç krijimit dhe rifreskimit permanent të tyre, përdoren kryesisht në ato raste kur vihet në rrezik jeta, shëndeti i popullatës apo prona publike dhe private, që në thelb të tyre përbëjnë pjesë në ato marrëdhënie juridike shoqërore, mbrojtja e të cilave përbën një interes të lartë publik.

Pikërisht për nga shumëllojshmëria dhe rëndësia e materialeve, që përbëjnë rezervat shtetërore, ligjvënësi në nenin 5, pika 3, të ligjit ekzistues ka përcaktuar se lista përbërëse e mallrave rezervë në lloje e sasi, e ndarë sipas grupeve, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 1128, datë 05.08.2008, ka miratuar listën përbërëse të mallrave rezervë shtetërore, në lloje dhe sasi, e ndarë sipas grupeve, si dhe limiti minimal për secilin artikull, ku në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, parashikohet edhe grupi “A” i mallrave rezervë shtetërore si më poshtë: prodhime ari, argjendi, platini e të tjera; mjete të rënda për çdo lloj transporti; grurë, si dhe mallra të ndryshme tepër vëllimorë.

Kuvendi i Shqipërisë për livrimin e mallrave të grupit “A”, që kanë një rëndësi të lartë dhe një vlerë të konsiderueshme për rezervat shtetërore, ka përcaktuar në nenin 10, pika 1, të ligjit ekzistues se livrimi dhe shitja e mallrave rezervë të grupit “A” bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave me propozimin e ministrit. Ndërkohë, me ndryshimet që propozohen të realizohen me ligjin nr. 36/2019, Kuvendi ka miratuar ndryshimin pikërisht për këtë pikë, duke parashikuar se livrimi dhe shitja e mallrave rezervë të grupit “A” bëhet me urdhër të Kryeministrit me propozimin e ministrit.

Siç u përmend edhe më sipër, ky ndryshim justifikohet nga qeveria dhe Kuvendi me të vetmin argument se thjeshtohet procesi i livrimit të mallrave rezervë shteti të grupit “A”, për shkak se miratimi i livrimit të mallrave të grupit “A” bëhet nëpërmjet një akti kolegjial, si ai i vendimit të Këshillit të Ministrave, dhe kjo sjellë vonesa në daljen e aktit të miratimit deri në livrimin e tyre.

Presidenti i Republikës vlerëson se ky argument i Këshillit të Ministrave dhe i Kuvendit të Shqipërisë nuk qëndron dhe nuk e justifikon aspak ndërmarrjen e kësaj nisme ligjore për miratimin e ndryshimeve në nenin 10, pika 1, të ligjit ekzistues.

Referuar parashikimeve të ligjit nr. 9000/2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, rezulton se argumenti i përdorur për ndryshimin e nenit 10, pika 1, të ligjit nr. 9900/2008 “Për rezervat materiale të shtetit” nuk qëndron dhe është ligjërisht i pajustificuar, pasi Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë është i detyruar të mbledhet në çdo kohë dhe nuk ka asnjë pengesë ligjore që të vështirësojë procesin vendimmarrës të tij, përfshi këtu edhe vendimmarrjen për livrimin e mallrave pjesë e rezervës shtetërore.

Republika e Shqipërisë ka në fuqi një bazë ligjore të shëndoshë që parashikon mbledhjen me urgjencë të Këshillit të Ministrave, për të ushtruar në çdo kohë përgjegjësitë dhe funksionet e tij.

Prandaj, çdo aludim se livrimi i mallrave të rezervave të shtetit mund të pengohet nga vonesa e vendimmarrjes së Këshillit të Ministrave nuk qëndron dhe është një argument fiktiv për të legjitimuar ndërhyrjen që po tentohet të realizohet në ligjin ekzistues nr. 9900/2008.

Për më tepër, nisur nga rëndësia dhe vlera që kanë mallrat e grupit “A” të rezervave të shtetit është në interes të publikut të gjerë që kontrolli ndaj çdo veprimi administrativ mbi këto mallra të jetë maksimal dhe jo një marrëdhënie midis dy autoriteteve politike, ministër dhe Kryeministër, ku pa dyshim kjo marrëdhënie varësie midis tyre mund të ndikojë drejtpërdrejt në objektivitetin e vendimmarrjes.

Presidenti i Republikës vlerëson se, nisur nga natyra dhe lloji i mallrave të grupit “A”, të rezervave të shtetit, është e domosdoshme të ruhet standardi ligjor i vendosur prej 11-vjetësh, ku vendimmarrja mbi mënyrën e administrimit të mallrave të grupit “A” t’i lihet vendimmarrjes së Këshillit të Ministrave.

Ndryshimet ligjore të miratuara me ligjin nr. 36/2019 dobësojnë mekanizmat e kontrollit mbi këtë proces, si dhe ulin nivelin vendimmarrës mbi mënyrën se si këto mallra do të administrohen dhe qarkullojnë në vijim, duke krijuar kështu një rrezik të shtuar që interesi publik të cenohet.

Për këto arsye, si dhe për të tjerat që i kemi parashtruar në arsyet bashkëlidhur dekretit, ju kërkojmë miratimin e dekretit të Presidentit nr.11 225, datë 15.07.2019.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zonja Fana!

Në fakt, deputetët e Komisionit për Sigurinë Kombëtare janë të njohur me dekretin e Presidentit të Republikës, por besoj edhe publiku për sa kohë është detyrim ligjor që dekreti

të botohet në Fletoren Zyrtare. Për qëndrimin që do të ketë Komisioni për Sigurinë ndaj argumenteve që parashtruat ju, unë do t'ia jap fjalën relatores zonjës Dhima.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Meqenëse është mbledhja e parë e Komisionit për Sigurinë, i uroj suksese në mbarëvajtjen e punës së tij!

Iniciativa ligjore për ndryshimin e pikës 1 të nenit 10 të ligjit nr. 9900 ishte një kërkesë e iniciuar nga vetë Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, si organ i qeverisjes së përgjithshme, e cila në fushën e përgjegjësisë së saj ka administrimin e mallrave rezervë të shtetit dhe kryen lëvrimin e tyre sipas autorizimit të organeve kompetente, drejtorit të Përgjithshëm për mallrat e grupit C, ministrit për mallrat e grupit B dhe me vendim të Këshillit të Ministrave për mallrat e grupit A.

Aktualisht, sipas bazës ligjore në fuqi, nenit 10 të ligjit nr. 9900/2008, lëvrimi i mallrave të grupit B dhe C bëhet me anë të një akti individual: “urdhër ministri” dhe “urdhër i drejtorit të Përgjithshëm”. Kjo mënyrë e bën më të lehtë dhe më të shpejtë lëvrimin e mallrave të grupeve përkatëse, sipas kushteve dhe rrethanave të parashikuara ligjërisht, ndërsa lëvrimi i mallrave të grupit A bëhet nëpërmjet një akti të një organi kolegjal, si vendimi i Këshillit të Ministrave, i cili sjell vonesa në miratimin e aktit dhe deri në lëvrimin e mallrave.

Ndryshimi i propozuar ka për qëllim unifikimin e procedurës së lëvrimit të mallrave rezervë të shtetit të secilit grup nëpërmjet një akti individual të një organi monokratik në rend hierarkik varësie, duke filluar nga drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit për mallrat e grupit C, ministri përgjegjës për rezervat materiale të shtetit për mallrat e grupit B dhe Kryeministri për mallrat e grupit A.

Argumentet dhe arsyetimi i Presidentit të Republikës për mosdekretimin e ligjit nr. 36/2019 nuk qëndrojnë. Regjimi juridik i administrimit dhe lëvrimit të mallrave rezervë të shtetit në asnjë rast nuk dobësohet për arsyet e mëposhtme.

Së pari, referuar nenit 3 të ligjit nr. 9900, datë 10.04.2008: “Rezervat materiale të shtetit krijohen për të ndërhyrë në mënyrë operative për mbrojtjen e popullsisë, të ekonomisë dhe mbrojtjen e vendit në situata të gjendjes së jashtëzakonshme, gjendjes së emergjencës civile, veprimeve terroriste, veprimeve ushtarake (në gjendje lufte), të cilat sjellin dëme të menjëhershme dhe të rënda për jetën, për shëndetin e popullatës dhe të gjësë së gjallë, për pasurinë, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin. Rezervat materiale të shtetit përdoren edhe për dhënien e ndihmave humanitare në përputhje me normat e së drejtës ndërkombëtare”. Pra, siç sanksionohet në këtë dispozitë të ligjit është i vetëkuptueshëm qëllimi thelbësor i kësaj baze ligjore, është ndërhyrja në mënyrë të menjëhershme për t'i ardhur në një kohë sa më të

shpejtë në ndihmë popullsisë, ekonomisë dhe mbrojtjes së vendit, situatave të cilat mund të krijohen si nga shkaqe natyrore apo për shkaqe të krijuara si rezultat i veprimtarisë njerëzore. Gjatë këtyre viteve kemi pasur shpesh situata të emergjencave, të cilat kërkonin livrimin e menjëhershëm të mallrave të kategorisë A, më konkretisht mjetet e tonazhit të lartë, por për shkak të procedurës aktuale, hartimit të projektvendimit dhe praktikës shoqëruese, marrjes së mendimit nga ministritë e linjës dhe miratimit në një nga mbledhjet javore të Këshillit të Ministrave nuk është arritur që këto mallra të lëvrohen në kohë.

Së dyti, arsyetimi i Presidentit se nisma ligjore për miratimin e ligjit nr. 36/2019 është i pajustifikuar dhe bie ndesh me rendin kushtetues dhe argumentimi i tij për cenimin e interesit publik nga kjo iniciativë për ndryshimin përkatës në legjislacionin ekzistues nuk qëndron, pasi nisma dhe kërkesa për ndryshimin e ligjit vjen nga vetë struktura, e cila ka përgjegjësinë ligjore për administrimin e mallrave rezervë të shtetit. Gjithashtu, për miratimin e ligjit është ndjekur e gjithë praktika dhe procedurat ligjore të parashikuara për miratimin e projektligjit në Kuvend sipas VKM-së nr. 584, datë 28.08.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar. Pra, për këtë projektligj Këshilli i Ministrave në cilësinë e organit që e ka pasur këtë të drejtë, jo vetëm që ka shprehur dakordësinë për këtë nismë, por ka qenë po ky organ, i cili ka propozuar ndryshimin e ligjit në Kuvend.

Argumenti se livrimi i mallrave pjesë e rezervës shtetërore sipas mënyrës së re nëpërmjet urdhrit të Kryeministrit nuk garanton plotësisht mbrojtjen e interesit publik në procedurat e administrimit dhe livrimit të mallrave që përbëjnë mallrat e grupit kryesor rezervë të shtetit nuk qëndron, pasi edhe pse livrimi i mallrave të grupit A, sipas ndryshimeve ligjore bëhet me urdhër të Kryeministrit, ky akt administrativ edhe pse është individual, para se të nënshkruhet i nënshtrohet kontrollit të ligjshmërisë si për çdo akt tjetër nga strukturat kompetente për garantimin e ligjshmërisë së akteve administrative.

Nëse do të vijojmë në logjikën e argumentimit të Presidentit, mallrat e grupit B dhe mallrat e grupit C, të cilat lëvrohen me akte individuale, duhet të kishin sjellë cenimin e interesit publik, ndërkohë që deri më sot nuk ka pasur raste të tilla. Pra, fakti se livrimi i mallrave rezervë të shtetit bëhet nga një organ monokratik apo kolegjal nuk lidhet kurrësi me cenimin e interesit publik.

Gjithashtu, në vijim për sa më sipër, referuar nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, si dhe kreut II, të VKM-së nr. 584, datë 28.08.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, i ndryshuar, aktet e miratuara nga Këshilli i Ministrave janë të karakterit normativ dhe atij individual. Aktet e karakterit normativ janë akte të

përgjithshme dhe abstrakte që rregullojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse një çështje të caktuar. Hierarkia superiore e VKM-së shprehet edhe në faktin se në zbatimin e tyre dalin urdhra dhe udhëzime të ministrave të linjës. Për vetë natyrën e tyre, vendimet e Këshillit të Ministrave rregullojnë një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk janë shteruar në zbatimin e tyre. Aktet individuale të nxjerra nga Këshilli i Ministrave janë në numër të kufizuar. Aktet individuale të nxjerra nga Këshilli i Ministrave mund të përkufizohen në të njëjtën mënyrë me përcaktimet e Kodit të Procedurave Administrative për aktin administrativ individual, i cili është:

“Akti administrativ individual” është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete. Për këtë arsye, duke qenë se akti i KM-së për lëvrimin e mallrave rezervë të shtetit të klasifikuar në kategorinë A për nga karakteri nuk është akt normativ dhe as individual, por që më së shumti i ngjason një autorizimi për nxjerrjen e tij nuk duhet të përbëjë domosdoshmëri ndjekja e procedurave standarde të miratimit të një akti normativ apo individual

Së treti, në arsyetimin e tij Presidenti argumenton se nisur nga rëndësia dhe vlera që kanë mallrat e grupit A të rezervave materiale të shtetit është në interes të publikut të gjerë që kontrolli ndaj çdo veprimi administrativ mbi këto mallra të jetë maksimal dhe jo një marrëdhënie midis dy autoriteteve politike ministër–kryeministër, ku padyshim kjo marrëdhënie varësie midis tyre mund të ndikojë drejtpërdrejt në objektivitetin e vendimmarrjes.

Nisur nga një analizë e thjeshtë e këtij arsyetimi arrijmë në përfundimin se ky argumentim nuk qëndron për faktin se edhe në Këshillin e Ministrave ka të njëjtën natyrë politike si Kryeministri apo ministri dhe raporti i varësisë Këshilli i Ministrave - ministër është i ngjashëm me atë Kryeministër – ministër, pasi, siç jeni në dijeni, Këshilli i Ministrave është një organ kolegjal, i cili kryesohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje ministrat e linjës.

Sa më sipër, sjellim edhe një herë në vëmendje se lëvrimi i mallrave rezervë të shtetit nëpërmjet aktit kolegjal vetëm do të shtojë procedurat, burokracitë dhe vonesat për lëvrimin e tyre në mënyrë operationale dhe efektive.

Siç kemi përmendur edhe më lart, lëvrimi i mallrave rezervë të grupit A me urdhër të Kryeministrit nuk nënkupton lëvrimin e tyre jashtë kriterëve të përcaktuar në ligjin nr. 9900, datë 10.04.2008, pasi edhe në këto raste akti administrativ individual i nënshtrohet kontrollit ligjor para nënshkrimit nga strukturat kompetente të ngarkuara me ligj, për garantimin e ligjshmërisë së tij.

Sa argumentuam më lart, nisma ligjore për ndryshimin e nenit 10, pika 1, e ligjit nr.9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit” është e ligjshme, është e justifikuar dhe nuk cenon interesin publik në administrimin e mallrave rezervë të shtetit.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Dhima!

Kemi dy qëndrime. Një qëndrim të iniciuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe, njëkohësisht, të mbështetur nga parlamenti më herët, që të bëhet ndryshimi përkatës në ligjin “Për rezervat materiale të shtetit”, i cili lejon që mallrat e kategorisë A, ku përfshihen prodhimet e arit, argjendit, platinës, por përfshihen edhe mallra të natyrave të tjera, si mjete të tonazhit të rëndë, gruri apo mallra të tjerë, të mund të lëvrohen (dihet që rezervat materiale përdoren gjithmonë në raste emergjencash civile ose në raste fatkeqësish të ndryshme të shkaktuara nga vullneti i njeriut ose jo, por që janë të tilla që i shërbejnë ardhjes në ndihmë të popullatës, mbrojtjes së ekonomisë. Pra, janë raste përjashtimore, raste krejt të veçanta, të jashtëzakonshme do të thosha, kur vihen në përdorim ose lind nevoja e përdorimit të këtyre mallrave rezervë.

Për mallrat e kategorisë A, ligji aktual, ligji i vitit 2008, parashikonte që lëvizja e tyre të bëhej vetëm me vendim të KM-së, ndërkohë që propozimi i ardhur në Kuvendin e Shqipërisë dhe, natyrisht, i mbështetur më parë nga ne, ka qenë që për të mënjeluar të gjitha burokracitë apo vonesat që sjell në vetvete organizimi i një mbledhjeje të KM-së, lëvrimi i mallrave të tillë të bëhet në një mënyrë më të thjeshtë me një operim më të thjeshtë, siç është ai me urdhër të Kryeministrit, ndërkohë që ka propozim nga ministri përkatës për të iniciuar procedurën.

Qëndrimi i Presidentit të Republikës është i ndryshëm. Presidenti i qëndron argumentit që lëvrimi i mallrave të tillë duhet të bëhet me VKM për faktin që operimi në mënyrën që ne përshkruam, ministër-kryeministër, është më pak transparente dhe si e tillë ajo do të cenonte interesat e publikut.

Për këto dy qëndrime ne jemi mbledhur sot.

Unë do t’ju ftoja, të dashur kolegë, nëse keni pyetje për përfaqësuesin e institucionin e Presidentit të Republikës ose edhe për relatorin, duke ju kujtuar se ne sjellim argumente kundër ose pro vetëm mbi ato që Presidenti ka paraqitur në dekretin e tij, jo të tjera. Pra, diskutimi përqendrohet në këtë argument që sapo e përmendëm.

Urdhëroni, zoti Murrizi!

Muslim Murrizi – Mirë do të ishte të kishte ndonjë përfaqësues nga qeveria, se në tabelën e mallrave me kategorizimin përkatës A, B dhe C është futur si mall i kategorisë A gruri.

Po misri pse jo? Po produktet e grurit, llokumet, patatinat pse jo? Për floririn e marr vesh, se gjithë halli i floririt është, nuk është se i bie kujt mendja për grurë e për misër, por meqenëse është futur gruri si mall i kategorisë A, pse nuk janë futur nënproduktet e tij? Pse nuk është futur misri, elbi, patatja? Çfarë është pasur parasysht?

Ermonela Felaj – Lista përbërëse e mallrave rezervë materiale të shtetit dhe kategorizimi i tyre është bërë me një VKM të vitit 2008. Pra, ne po flasim për një situatë ...

Muslim Murrizi – Që e ka bërë Berisha do të thuash?

Ermonela Felaj – Është bërë 11 vjet më parë dhe i vetmi ndryshim për të cilin po diskutojmë është ai për të cilin folëm pak më parë.

Muslim Murrizi – Unë nuk kam qenë në vitin 2008, por pse nuk kam qenë në vitin 2008, kjo nuk do të thotë se e humb të drejtën për të bërë pyetje sot. Pse është bërë nga qeveria e vitit 2008, as më bie mendja fare mua se kush e ka bërë, që të jemi të sigurtë. Unë thjesht po shoh se ka një diferencim, i cili është edhe diskriminim. Pse qenka më i mirë gruri se misri, se elbi, se patatja?

Kjo më duket shumë qesharake. Ndërsa për kthimin e dekretit nga Presidenti, ai kështu e ka arsyetuar dhe unë nuk bëj rolin e gjykatësit të institucionit të Presidentit, por për të qenë më praktik, madje unë nuk paskam qenë i vëmendshëm kur ka kaluar herën tjetër, nuk do të isha dakord fare që të ishin me urdhër të Kryeministrit, se këto duhej të shiteshin me urdhër të ministrit. Kryeministri të ruaj një farë tagri me institucionet që ka për të kontrolluar, se shumica e këtyre mallrave janë në bursë. Pra, të kontrollonte nëse janë shitur me vlerën referuese të bursës apo jo. Mund të aludohet se edhe qeveria është e ngushtë, siç është dhe duhet të ketë herë pas here... Por për të shitur 300 tonë grurë të mbledhet parlamenti në seancë, nuk më duket korrekte, përderisa janë mallra të rezervës së shtetit. Jam dyshues, pasi nuk e di pse mund të lindë nevoja të shitet, për shembull, ari, argjendi.

Ermonela Felaj – Në fakt, bëhet fjalë vetëm për livrimin, për lëvizjen dhe jo për shitjen, për këmbimin apo për asgjësimin.

Muslim Murrizi – Ne si shtet, zonja kryetare, kemi histori shumë interesante...

Ermonela Felaj – Në ligj janë të parashikuara të gjitha momentet e veçanta si dhe kur bëhen.

Muslim Murrizi – ...me këmbimin e arit të Ramiz Alisë në vitin 1989, kur i kemi humbur 300 milionë dollarë. Jemi shumë shtet interesant dhe kur bëhet fjalë për armë, na humb shpesh: një herë na humb atje në këmbim, e herë na humb në Kërrabë. Ndërsa këto të tjerat, besoj se janë dorë e dytë dhe më duken kot. Por, meqenëse zonja është nga Presidenca, unë dua të di ata që kanë bërë klasifikimin e kategorive të mallrave, madje u habita shumë kur pashë

grurin tek “A-ja”, prandaj pyeta. Gjithsesi, për ju nuk kam ndonjë pyetje. Mendova që jeni e qeverisë, se ne të opozitës rrallë e ndajmë kush është qeveria e kush Presidenca, me thënë të drejtën, na duken njëloj.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Murrizi!

Unë po shoh të dhënat e votimit elektronik të ndryshimit, për të cilin jemi duke diskutuar dhe shoh që ju, në fakt, nuk paskeni qenë ditën e votimit të këtij projektligjit.

(Deputeti Murrizi flet pa mikrofon.)

Në rregull jeni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të gjitha i thatë të vërteta para komisionit.

Atëherë, meqenëse fjala e zotit Murrizi ishte thjesht diskutim, nuk e di nëse ndonjëri nga kolegët e tjerë ka pyetje apo edhe diskutim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në këto kushte, më lejoni të them që ne, paraprakisht, i kishim parë me vëmendje argumentet në dekretin e sjellë nga Presidenti i Republikës. Sigurisht që kemi pasur kujdes për çdonjërin prej atyre argumenteve, ndërkohë që zonja Dhima lexoi edhe relacionin lidhur me këtë rast, por unë do të shtoja vetëm këtë fakt që, përkundër argumentit që sjell Presidenti i Republikës se humbet transparenca në rastin kur livrimi i mallrave të kategorisë “A” bëhet sipas marrëdhënies ministër – Kryeministër, dua të them që kjo rrit përgjegjësinë dhe transparencën, pasi besoj që edhe ju e pranoni, si juriste, që përgjegjësia kolektive nuk përbën përgjegjësi penale. Ndërsa në rastin konkret kemi një përgjegjësi individuale: merr një përgjegjësi përsipër ministri dhe Kryeministri për lëvizjen e mallrave të tilla. Pra, ne kemi siguruar që të rritet përgjegjësia në rastin e një vendimmarrjeje të tillë. Këtë unë, personalisht, do ta mendoja si argumentin kryesor kundër argumentit që sjell dekreti i Presidentit dhe, natyrisht, do të mbështesja qëndrimin, të cilin edhe zonja Dhima ia propozoi komisionit, që ne duhet të jemi pro ndryshimit të paraqitur në ligj më herët nga ana e qeverisë.

I ftoj kolegët që të kalojmë në procedurën e votimit.

Kush është pro dekretit nr. 11 225, datë 15.07.2019 të Presidentit të Republikës “Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 36/2019 “Për një ndryshim në ligjin nr. 9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit””? Asnjëri nga kolegët nuk shprehet dakord.

Kush është kundër dekretit të Presidentit të Republikës?

Atëherë, rrëzohet dekreti i Presidentit të Republikës për kthimin e ligjit për ndryshimin e bërë në ligjin “Për rezervat materiale të shtetit”.

Ju falënderoj, zonja Fana, për prezencën tuaj në Komisionin për Sigurinë Kombëtare dhe ju uroj ditë të mbarë!

Faleminderit, të nderuar kolegë, për pjesëmarrjen e sotme! Bashkë do të takohemi nesër në mbledhjen e radhës me rend dite marrëveshjen e bashkëpunimit me fondet IPA!

MBYLLET MBLEDHJA